



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

8 Dhjetor 2015

I/E nderuar deputet/e i/e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Si qytetarë të Kosovës dhe si taksapagues që kanë të drejtë të marrim pjesë në procesin demokratik të planifikimit të buxhetit të Kosovës, ne po ju shkruajmë për të shprehur shqetësimin tonë lidhur me projektbuxhetin ekzistues për vitin 2016. Ne nuk mendojmë që projektbuxheti reflekton në mënyrë adekuate nevojat themelore të qytetarëve të Kosovës. Në mënyrë specifike, ne kërkojmë që projektbuxheti për vitin 2016 t'i bëhen ndryshimet e mëposhtme, para aprovimit të tij. Më shumë detaje dhe shpjegime mund të gjinden më poshtë. Të gjitha rekomandimet janë të bazuara në hulumtime të bëra së fundi nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), të cilat mund të gjinden në uebfaqen tonë, ose të kërkojnë sipas nevojës.

Përmbledhje e rekomandimeve për Buxhetin 2016		
Të zvogëlohet shuma e alokuar në linjat buxhetore për:	Kategoria Ekonomike	Shuma
Kuvendin e Republikës së Kosovës	Paga dhe Mëditje	- 2,023,547€
Të gjitha ministrinë: mëditjet për zyrtarët	Paga dhe Mëditje/ Mallëra dhe Shërbime ¹	- ~6,000,000€
Vendimi 02/59 mbi pagat	Paga dhe Mëditje	?
Të rritet shuma e alokuar në:		
MASHT, Investime Kapitale në institucione para-shkollore	Investime Kapitale	+5,500,000€
MASHT, Pagat e mësimdhënësve/edukatorëve në institucionet para-shkollore.	Paga dhe Mëditje	+43,200€
Qendra e Studentëve, Prishtinë	Investime Kapitale	+100,000€
MPMS – Shërbime Sociale për strehimoret për dhunën në baza gjinore	Subvencione dhe Transfere	+90,000€
MPMS – Pensionet për të mbijetuarit/-at e dhunës seksuale gjatë luftës	Subvencione dhe Transfere	+1,800,000€
MPMS – Pensionet për kujdestarët e invalidëve civil	Subvencione dhe Transfere	+72,240€

Të zvogëlohen shpenzimet në pagat e deputetëve: Buxheti total i propozuar për deputetët në vitin 2016 është 4,047,093 €, pjestuar për 12 muaj, del një mesatare prej 2,810 € për deputet për muaj, kur konsiderojmë kategorinë ekonomike të "Pagave dhe Mëditjeve" në tërësi. Sipas Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, paga mesatare mujore në Kosovë është 360 €. Ne nuk mendojmë që një deputet i Kuvendit që paguhet **gati tetë herë më shumë** se paga e një qytetari mesatar të Kosovës, mund të përfaqësojë në mënyrë të denjë interesat e qytetarëve kosovarë. Më tutje, duke konsideruar bllokadën që ka ekzistuar në Kuvend për muaj të tërë gjatë vitit 2015, ne nuk mendojmë që deputetët kanë merituar paga kaq të larta, pasi që ata nuk kanë mundur të tejkalojnë mos-pajtimet e tyre në rastet kur nevojat e vërteta me të cilat janë ballafaquar kosovarët në jetën e tyre të përditshme, ishin në rrezik. Ne fajësojmë si pozitën, ashtu edhe opozitën për dështimin e tyre për të gjetur një mes në çështjet që ndikojnë në jetën e përditshme të kosovarëve. Prandaj, ne nuk mendojmë që deputetët meritojnë paga kaq të larta. Ne bëjmë thirrje për zvogëlimin e kësaj linje buxhetore **për gjysmë**, që në total do të ishte 2,023,547 €, me qëllim që burimet që mbesin të mund të përdoren për mirëqenien e të gjithë kosovarëve, siç propozohet më poshtë. Kjo prapë do t'i lejonte deputetët që të fitojnë, mesatarisht **katër herë** më

¹ Është mjaft konfuz fakti që RrGGK ka prova që fondet për mëditje mirren nga që të dyja këto kategori të shpenzimeve.

shumë se paga mesatare mujore në Kosovë. Kjo do t'i ruante 2,023,547 € për qëllime të tjera, të cilat përshkruhen më poshtë.

Të suspendohen përkohësisht mëditjet për vizita jashtë vendit, dhe të zvogëlohen shpenzimet për mëditje: Sipas Lëvizjes FOL, më shumë se 3,305,026 € janë shpenzuar në mëditje në Kosovë vetëm në vitin 2014. Për më shumë, më tepër se gjysma e institucioneve të Kosovës refuzuan që të jenë transparentë lidhur me këto informata; mund të vlerësohet se mesatarisht mund të jenë shpenzuar dy herë më shumë se kaq. Përvoja jonë me realizimin e hulumtimeve me institucione të ndryshme tregon që shumë zyrtarë kyç pothuaj *gjithmonë* gjinden në vizita studimore dhe grupe punuese jashtë vendit. Nëse gjinden gjithmonë jashtë vendit, si arrijnë t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre në Kosovë? Së dyti, organizimi i vizitave jashtë vendit, dërgon burimet shumë të limituara të Kosovës në vende të tjera, në vend se këto burime të çmueshme të riinvestohen brenda Kosovës. Së treti, ne besojmë që shumat e shpenzuara në mëditje për këto udhëtime, mund të shpenzohen në mënyra më të mira nga të cilat do të mund të përfitonin kosovarët. Përderisa ne nuk mund të kalkulojmë se sa para do të kurseheshin për shkak të mungesës së transparencës në shpenzimet aktuale, ne vlerësojmë se do të mund të kurseheshin deri në 6 milion euro. Më tutje, ne kërkojmë më shumë llogaridhënie nga të gjitha institucionet qeveritare lidhur me atë se si dhe nga kush shpenzohen mëditjet, përfshirë duke qenë kjo edhe pjesë e obligimit të tyre për integrimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Të tërhiqet vendimi 02/59 mbi pagat e zëvendës kryeministrave, ministrave, zëvendës ministrave, dhe Drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. (AKI), që është aprovuar me datën 17.11.2015. Sipas këtij vendimi zëvendës kryeministrat, ministrat, dhe Drejtori(ja) e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI) do të vazhdojnë të marrin 70% të pagave të tyre nga Qeveria e Kosovës edhe për një vit pas përfundimit të mandatit të tyre. Zëvendës ministrat do të marrin 70% të pagës së tyre edhe për gjashtë muaj pas përfundimit të mandatit të tyre. Duke konsideruar numrin shumë të lartë të ministrave (22), si dhe të zëvendës ministrave (27+)² që ka Kosova, RrGGK konsideron që këto të holla do të shpenzoheshin shumë më mirë në gjetjen e zgjidhjeve për zvogëlimin e papunësisë (shih më poshtë), sesa të shpenzohen në zyrtarë të qeverisë, që me siguri se nuk do të kenë vështirësi të gjejnë punë pas përfundimit të mandatit të tyre.

Të rritet buxheti për divizionin për Arsim Para-shkollor në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të ndërtuar më shumë institucione para-shkollore. Në vitin 2014, 41.6% e grave në Kosovë kanë qenë të papuna, ndërsa përqindja e grave që ishin ekonomikisht jo-aktive ishte 78.6%. Në vitin 2015, 24.7% e grave që nuk punonin (dhe 3.7% e burrave) kanë thënë që arsyeja kryesore pse ata nuk punojnë është sepse kanë përgjegjësi të tjera në shtëpi, përfshirë përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe të moshuarve (anketimi mbarë kombëtar i ekonomive familjare nga RrGGK). Përkujdesja është një prej arsyeve kryesore që pengon gratë të kyçen në tregun e punës. Momentalisht, Kosova nuk ka mjaft institucione dhe çerdhe publike që janë financiarisht të përballueshme, duke mos përmbushur objektivat e BE-së për përkujdesjen ndaj fëmijëve dhe edukimin në moshë të hershme (që përshkruhet në Objektivat e Barcelonës). Investimi në më shumë institucione para-shkollore dhe çerdhe mund të ofrojë përkujdesje që do të lejojë veçanërisht më shumë gra të marrin pjesë në tregun e punës, si dhe do të krijonte vende të reja të punës për gratë dhe burrat. Në projektbuxhetin për vitin 2016, buxheti aktual i planifikuar për "investime kapitale në Arsimin Para-universitar" është 9,470,000 €, përfshirë edhe grantin qeveritar në shumë prej 8,570,000 €. Sipas zyrtarëve të MASHT-it ndërtimi i një institucioni të ri parashkollor, sipas modelit "tipik", përfshirë edhe inventarin, do të kushtonte 550,000 €. Investimi në 10 institucione para-shkollore/çerdhe të reja me një mesatare prej 12 edukatorëve në secilën, mund të krijojë 120 vende të reja të punës, që do të kontribuonte në përpjekjet e qeverisë për zvogëlimin e papunësisë. Bazuar në pagën mesatare në Kosovë, do të kërkonte edhe një rritje prej 43,200 € për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, në po të njëjten linjë buxhetore. Kjo do të kontribuonte që Kosova të përmbushë objektivat e BE-së për arsimim para-shkollor dhe do të rriste kualitetin e edukimit për fëmijë, që është qenësore për zhvillimin e mëtutjeshëm të Kosovës.

Të rritet alokimi buxhetor për Qendrën e Studentëve. Momentalisht, për Qendrën e Studentëve në Prishtinë janë planifikuar të alokohen 600,000 € për shpenzime kapitale. Edhe pse universiteti ka

² Vetëm 27 emra të zëvendës ministrave janë bërë publik në uebfaqet e ministrive, por RrGGK dinë edhe për ekzistimin e së paku 10 të tjerëve.

ndërtuar një konvikt të ri në vitin 2015, ende ka hapësirë për vetëm 44.5% të aplikuesve për banim. Gratë dhe vajzat përbëjnë shumicën e studentëve që banojnë në konvikte (60.3%). Ato ka të ngjarë që të mbështeten më shumë në të tilla lloje banimi sesa djemtë, pasi që është më e përballueshme financiarisht dhe ofron siguri. Rritja e vendeve për banim në konvikte në Qendrën e Studentëve, do të ju mundësonte më shumë vajzave dhe djemve që të vijojnë studimet në universitet, veçanërisht atyre që jetojnë jashtë Prishtinës, të cilët mund të mos kenë mundësi tjetër që t'i përballojnë shpenzimet e jetesës dhe transportit. Përmirsimi i qasjes në arsimimin e lartë mund të kontribuoj në përmirsimin e kapaciteteve të fuqisë punëtore kosovare në të ardhmen dhe në zvogëlimin e papunësisë në afat më të gjatë. Ndërtimi i një konvikti shtesë do të kushtonte 100,000 € në shpenzime kapitale.

Të rritet buxheti i Divizionit për Shërbime Sociale në MPMS për të financuar krijimin edhe të tri strehimoreve për djem/burra, për persona LGBTI, dhe për qytetarë që jetojnë në veri të Kosovës, respektivisht. Duke filluar prej muajit prill të vitit 2015, shuma që i paguhet secilës strehimore për person të strehuar është 208.33 € për muaj, në total një maksimum prej 30,000 € për vit, për strehimore, për personat që përjetojnë dhunë në baza gjinore. Momentalisht, linja buxhetore e Divizionit për Shërbime Sociale të MPMS-së (subvencione dhe transfere) është planifikuar që për vitin 2016 të jetë 4,500,000 €. RrGGK propozon që kjo shumë të rritet për 90,000 €, në mënyrë që të financohen edhe tri strehimore më shumë, që përmes kontratave, do të ju shërbenin personave të cilët sipas hulumtimeve të RrGGK-së janë të nën-shërbyer nga strehimoret ekzistuese, përfshirë djemtë/burrat që përjetojnë dhunë në familje; personat Lezbikë, Gei, Biseksual, Transgjinorë dhe Interseks (LGBTI); dhe një strehimore në veri të Kosovës.

Të ndahet buxhet për të mbijetuarit/-at e dhunës seksuale. Aktivistët kanë vlerësuar që kjo do të kushtojë rreth 1,800,000 € në vitin 2016, sipas Ligjit të ri, për 500 të mbijetuar/-a të dhunës në familje që të marrin nga 300 € në muaj. Kjo duhet të monitorohet me kujdes për planifikime buxhetore në të ardhmen.

Të rritet buxheti për personat që kujdesen për invalidët civil të luftës në Kosovë. Pensioni për kujdestarët e invalidëve të UÇK-së është 4.5 herë më i lartë sesa ai i kujdestarëve të invalidëve civil. Por, puna që ata e kryejnë është e njëjtë. Duke konsideruar principin e BE-së për pagesë të njëjtë për punë të njëjtë, kjo është diskriminuese ndaj kujdestarëve të invalidëve civil, që në të shumtën e rasteve janë gra prej zonave rurale. Momentalisht buxheti i alokuar për Departamentin e Familjeve të Dëshmorëve dhe Invalidëve të Luftës, në kategorinë ekonomike të subvencioneve dhe transfereve është planifikuar të jetë 38,000,000 € për vitin 2016, dhe duhet të rritet për 72,240 € për të adresuar këtë pabarazi.

Në përgjithësi, ne kërkojmë që në të ardhmen ju të filloni një kërkim zyrtarë për nevojat dukshëm të paplotësuara të Kosovës në shërbime për punët e kujdesit ndaj të moshuarve, fëmijëve, dhe personave me aftësi të kufizuara. Duke investuar në sektorin e kujdesit në Kosovë do të mund të krijoheshin me mijëra vende pune, të zvogëlohet papunësia, dhe në veçanti të ju mundësohet më shumë grave që të bëhen pjesë e fuqisë punëtore.

Ne do të ishim të gatshëm të ju ofronim prova të mëtutjeshme në mbështetje të rekomandimeve tona nëse ju i kërkon.



Igballe Rogova
Drejtore Ekzekutive
Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës